

VENDIM
Nr.647, datë 30.9.2004

**PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE TË ISH-VENDKOMANDËS TË KOHËS SË VEÇANTË
NË QYTETIN E VLORËS NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e mjediseve të katit përdhe dhe të tre mjediseve të katit të parë të ndërtesës së ish-vendkomandës të kohës së veçantë në qytetin e Vlorës, të cilat janë në administrim të prefektit të qarkut të Vlorës, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, prefekti i qarkut të Vlorës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano